

PASQYRAT E BILANCIT

Per vitin ushtrimor te mbyllur me 31 Dhjetor 2013

AKTIVET	Shenime	31.12.2013	31.12.2012
Aktivitet Afatshkurtra			
Mjete monetare	4	391,784	1,748,693
Llogari dhe kerkesa te arketueshme	5	36,117,991	42,054,130
Llogari dhe kerkesa te tjera te arketueshme	6	3,859,688	12,903,357
Inventari	7	12,718,648	9,237,758
Totali I Aktiveve Afatshkurter		53,088,111	65,943,938
Aktivitet Afatgjata			
Aktive Afatgjata Materiale		1,981,195,784	2,015,035,721
Aktive te tjera afatgjata ne proces		979,453,538	769,844,112
Totali I Aktiveve Afatgjata	8	2,960,649,322	2,784,879,833
Totali I Aktiveve		3,013,737,433	2,850,823,771
DETYRIMET DHE KAPITALI			
Detyrimet Afatshkurtra			
Huate dhe obligacionet afatshkurtra	9	182,736,230	204,109,587
Te pagueshme ndaj furnitoreve	10	585,589,589	447,340,057
Detyrime tatimore	11	8,200,774	19,352,109
Totali I Detyrimeve Afatshkurtra		776,526,593	670,801,753
Detyrimet Afatgjata			
Hua, Bono dhe detyrime nga Qeraja Financiare	12	590,307,769	792,612,698
Huamarrje te tjera Afatgjata	13	644,926,530	555,884,531
Totali I Detyrimeve Afatgjata		1,235,234,299	1,348,497,229
Totali I Detyrimeve		2,011,760,892	2,019,298,982
Kapitali			
Kapitali Aksionar	14	597,686,000	597,686,000
Rezerva Ligjore		8,905,056	
Rezerva te tjera		224,933,732	55,737,675
Fitimi I pashperndare		170,451,753	178,101,114
Totali I Kapitalit		1,001,976,541	831,524,789
Totali I Detyrimeve dhe Kapitalit		3,013,737,433	2,850,823,771

Shenimet shpjeguese jane pjese integrale e pasqyrave financiare

PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

Per vitin ushtrimor te mbyllur me 31 Dhjetor 2013

Pershkrimi	Shenime	31.12.2013	31.12.2012
Shitje neto	15	417,608,962	440,217,379
Te ardhura te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit	16	5,173,373	3,456,211
Puna e kryer nga njesia ek per qellime te veta	17	7,794,199	0
Mallra, lendet e para dhe sherbimet	18	(4,251,506)	(920,967)
Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfryt	19	(26,197,393)	(34,573,725)
Shpenzimet e personelit	20	(53,197,644)	(27,107,576)
Pagat		(45,928,238)	(23,230,371)
Shpenzimet e sigurimeve shoqerore		(7,269,406)	(3,877,205)
Amortizimi dhe Zhvleresimet	21	(121,531,499)	(126,606,924)
Fitimi (humbja) nga veprimtarite e shfrytezimit		225,398,492	254,464,398
Te ardhura dhe shpenzime financiare nga interesi	2	(35,230,182)	(50,488,917)
Fitimi dhe humbje nga kursi i kembimit		(73,120)	(4,443,298)
Totali i te ardhurave dhe shpenzimeve financiare	22	(35,303,302)	(54,932,215)
Fitimi (humbja) para tatimit		190,095,190	199,532,183
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin		(19,643,437)	(21,431,069)
Fitim (humbje) neto e vitit financiar	23	170,451,753	178,101,114

Shenimet shpjeguese jane pjese integrale e pasqyrave financiare

PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE

Per vitin ushtrimor te mbyllur me 31 Dhjetor 2013

Pershkrimi	31.12.2013	31.12.2012
Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit		
Fitimi para tatimit	190,095,190	199,532,183
Rregullime për:		
Amortizimin	121,531,499	126,606,924
Humbje nga këmbimet valutore	73,120	4,443,298
Shpenzime për interesa	35,230,182	50,488,917
Rritje(-)/rënie(+) në tepricën e kërkesave të arkëtueshme nga aktiviteti, si dhe kërkesave të arkëtueshme të tjera	14,979,808	49,130,231
Rritje/rënie në tepricën inventarit	(3,480,890)	(6,725,526)
Rritje/rënie në tepricën e detyrimeve, për t'u paguar nga aktiviteti	105,724,839	(26,410,745)
Parate e përfituara nga aktivitetet	464,153,748	397,065,282
Interesi i paguar	(35,230,182)	(50,488,917)
Tatim mbi fitimin njohur ne PASH	(19,643,437)	(21,431,069)
Paraja neto nga aktivitetet e shfrytëzimit	409,280,129	325,145,296
Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese		
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	(297,300,988)	(99,495,887)
Paraja neto e përdorur në aktivitetet investuese	(297,300,988)	(99,495,887)
Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare		
Të ardhura nga huamarrje afatgjata	(113,262,930)	(230,495,449)
Paraja neto e përdorur në aktivitetet financiare	(113,262,930)	(230,495,449)
Diferenca konvertimi MM te mbajtura ne monedhe te huaj	(73,120)	(4,443,298)
Rritja (+)/rënia(-) neto e mjeteve monetare	(1,356,909)	(9,289,338)
Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël	1,748,693	11,038,031
Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël	391,784	1,748,693

"ROMANO-PORT" SHA DURRES

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL

Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013


Pershkrimi	Kapitali aksionar	Rezerva te tjera	Rezerva Ligjore	Fitimi I pa shperndare	TOTALI
Pozicioni me 31 Dhjetor 2011	597,686,000	-		55,737,675	653,423,675
Fitimi neto per periudhen kontabel				178,101,114	178,101,114
Emetimi I aksioneve	-			-	-
Transferim ne rezerva ligjore		55,737,675		(55,737,675)	-
Aksionet e thesarit te riblera	-			-	-
Pozicioni me 31 Dhjetor 2012	597,686,000	55,737,675		178,101,114	831,524,789
Fitimi neto per periudhen kontabel				170,451,753	170,451,753
Transferim ne rezerva ligjore dhe rezerva te tjera		169,196,057	8,905,056	(178,101,114)	
Aksionet e thesarit te riblera					
Pozicioni me 31 Dhjetor 2013	597,686,000	224,933,732	8,905,056	170,451,753	1,001,976,541

Pasqyrat financiare se bashku me shenimet shpjeguese jane aprovuar nga drejtimi i shoqerise me date ___ / ___ /2014

Piro Bare



Helidon Kodra



Shenimet shpjeguese jane pjesë integrale e pasqyrave financiare

"ROMANO-PORT" SHA DURRES

Shenime mbi Pasqyrat financiare
Per ushtirmin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

1. Te dhena te pergjithshme mbi Shoqerine

Shoqeria **"ROMANO-PORT" SHA** eshte krijuar ne vitin 2003, me vendim gjykate Nr. 30465 Date 28.10.2003. Veprimtaria e saj rregullohet nga statuti i saj.

Ortaket e kompanise jane Z. PIRO BARE me 99.84% te aksioneve, Z. FLORENC GJIKURIA me 0.06% dhe Z. XHEVAT RIRA me 0.08% te aksioneve te shoqerise.

Kapitali i shoqerise eshte 597,686,000 leke.

Administrator i shoqerise eshte Z. Piro BARE.

Selia e shoqerise eshte: 700 MI ne veri te Hidrovorit, Porto-Romano, Durres. Ajo eshte regjistruar prane organeve tatimore te rrethit te Durres me license Nr. 552350 dhe NIPT K516255010.

Aktiviteti kryesor i kesaj shoqerie eshte: Ndertim, shfrytezim porti, shkarkim e analiza te lendeve djegese, ruajtje objekti, perdorim mjete detare. Gjate vitit 2013 kompania ka vazhduar operimin e saj duke ofruar sherbimin e shkarkimit te naftes, benzines dhe gazit. Ky investim eshte nje koncesion per 30 vjete dhene nga qeveria shqiptare me te drejte riparteritje. Gjithashtu shoqeria po nderton dhe dallgethyesin Jug Perindimore.

2. Baza e pregatitjes se pasqyrave financiare

a. Menyra e Pregatitjes se Pasqyrave Financiare

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne Ligjin nr.9228 mbi "Standardet Kombetare te Kontabilitetit (SKK)".

b. Ndryshime ne metodat e vleresimit kontabel

Efektet e ndryshimeve ne vleresimin kontabel njihen ne periudhen ne te cilen vleresimi (cmuarja) eshte kryer.

c. Monedha Funktionale dhe me te cilen paraqiten pasqyrat

Pasqyrat Financiare paraqiten ne monedhen vendase Lek (ALL), e cila eshte monedha funksionale dhe raportuese e Shoqerise. Informacioni ne pasqyrat financiare eshte paraqitur ne Leke, ndersa ne shenimet e pasqyrave financiare eshte ne mije leke.

d. Vleresime dhe gjykime

Pergatitja e pasqyrave financiare kerkon nga drejtuesit te ushtrojne gjykimin e tyre ne procesin e zbatimit te politikave kontabel te Shoqerise dhe shumave te raportuara te

Shenimet shpjeguese jane pjese integrale e pasqyrave financiare

aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në vecanti, informacion mbi fushtat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumën e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

3. Permbledhje e politikave dhe rregullave kryesore kontabel

Politikat kryesore kontabel të zbatuara nga shoqëria janë të përshkruara në vijim:

a. Vlerësimet të likuiditeteve

Gjendjet e likuiditeteve përfshijnë gjendjen e parave në arke dhe në llogaritë rrjedhese në banke në lekë dhe në monedha të huaja sipas ekstrakteve bankare.

b. Vlerësimin e kërkesave për arketim

Kërkesat për arketim vlerësohen me vlerën nominale (të skontuara nëse është materiale) minus humbjen nga zhvlerësimi.

c. Vlerësimin e detyrimeve të pagueshme ndaj furnitoreve

Detyrimet ndaj furnitoreve janë të vlerësuara mbi bazën e vlerësimit të tyre nominalë.

d. Huatë

Huatë të marra me interes regjistrohen fillimisht me vlerën e drejtë. Pas njohjes fillestare janë të vlerësuara me koston e amortizuar. Interesat e perlllogaritur janë njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve si dhe detyrimet në llogarinë e interesave të perlllogaritura.

e. Veprimet në monedha të huaja

Transaksionet në monedha të huaja regjistrohen në kontabilitet me kursin e datës së kryerjes së transaksionit.

Asetet dhe detyrimet monetare në monedha të huaja janë përkthyer në pasqyrën e bilancit me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë me 31.12.2013. Diferencat nga kursi i këmbimit të lindura nga përkthimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

"ROMANO-PORT" SHA DURRES

Shenime mbi Pasqyrat financiare

Per ushtirimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

Asetet dhe detyrimet jo monetare qe maten me kosto historike ne monedhe te huaj perkthehen duke perdorur kursin e kembimit ne daten e transaksionit.

Asetet dhe detyrimet jo monetare ne monedhe te huaj qe paraqiten me vleren e drejte perkthehen me kursin e kembimit ne daten kur vlera e drejte eshte percaktuar.

Kursi i kembimit per dy monedhat e huaja kryesore me monedhen vendase sipas te Bankes se Shqiperise me 31.12.2013, ka qene respektivisht si me poshte:

	2013	2012
1 Euro	140.20	139.59
1 USD	101.86	105.85

f. Vleresimin e Gjendjeve te Inventarit.

Inventaret regjistrohen ne kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes perfshin te gjitha shpenzimet e kryera per ta sjelle inventarin ne vendin dhe kushtet ekzistuese. Ne rastin e prodhimit te produkteve ne kosto perfshifet dhe pjesa respektive e shpenzimeve te pergjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Koston e inventarit llogaritet duke perdorur metoden e mesatares se ponderuar

Gjendjet e Inventarit jane te vleresuara ne bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar kete vleresim, si vleren më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

g. Vleresimi Aktiveve Afatgjata Materiale

Aktivet Afatgjata Materiale (AAM) paraqiten ne bilanc me vleren e tyre neto (kosto historike minus amortizimin e akumuluar). Shtesat e Aktiveve Afatgjata regjistrohen ne kontabilitet me koston se marrjes ose te prodhimit te tyre.

Kosto e marrjes perfshin te gjitha shpenzimet e kryera per ta sjelle ate aktiv ne vendin dhe kushtet ekzistuese.

Kosto e prodhimit te tyre perfshin te gjitha shpenzimet e kryera per te prodhuar ate aktiv ne vendin dhe kushtet ekzistuese ku permendim shpenzimet e materialeve te para, shpenzime paga dhe sigurime shoqerore, taksa dhe tarifa doganore, interesa kredie, shpenzime mirmbajtje zyre dhe makina, amortizimi i Aqt-ve qe jane perdorur dhe shpenzime te tjera te njohura administrative.

"ROMANO-PORT" SHA DURRES

Shenime mbi Pasqyrat financiare

Per ushtirimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

Normat e amortizimit te aplikuara jane sipas kerkesave fiskale dhe nuk marrin ne konsiderate vleresimin e amortizimit sipas jetes se dobishme te aktivitetit. Per llogaritjen e amortizimit jane aplikuar keto norma amortizimi:

Kategoria e AQT-ve	Norma e Amortizimit ne %		Metoda e llogaritjes
	2013	2012	
Toka	0	0	
Ndetime e instalime	5	5	Mbi vleren e mbetur te AQT-ve
Makineri e Paisje	5-20	5-20	
Mjete transporti	20	20	
Paisje zyre	20	20	
Paisje kompiuterike	25	25	
Instrumenta dhe vegla pune	20	20	

Llogaritja e amortizimit per AQT e hyra gjate vitit behet duke filluar nga data nje e muajit pasardhes.

h. Provizionet

Nje provizion krijohet nese ekziston nje detyrim ligjor ose konstruktiv si rezultat i ngjarjeve te kaluara; ekziston mundesia qe per shlyerjen e detyrimit dhe nese mund te behet nje vleresim relativisht i sakte i shumes se detyrimit.

i. Te Ardhurat

Te ardhurat regjistrohen sipas mases se realizimit te tyre dhe lidhjes qe ato kane me ushtrimin e mbyllur kontabel, pamvaresisht nese arketimi i tyre apo i nje pjese prej tyre do te ndodhe ne nje ushtrim pasardhes. Te ardhurat nga interesat regjistrohen ne momentin e maturimit te tyre.

Të ardhurat janë përfitimet ekonomike bruto (pa TVSH dhe zbritjet tregtare), të marra gjatë periudhës kontabël, si rezultat i rrjedhës normale të veprimtarisë së njësisë ekonomike raportuese, atëherë kur këto përfitime ekonomike çojnë në rritjen e kapitaleve te veta.

j. Tatimi mbi fitimin

Tatimi aktual mbi fitimin eshte llogaritur ne perputhje me dispozitat e ligjit "Per tatimin mbi te Ardhurat ne Republiken e Shqiperise" duke perfshire gjithe detyrimet per tatimin mbi fitimin te pagueshme per vitin ushtrimor. Tatimet aktuale jane tatime per tu paguar qe rezultojne nga te ardhurat e tatueshme, duke perdorur shkallen tatimore qe eshte ne fuqi ne daten e bilancit, dhe çdo rregullim ne tatimet per tu paguar qe rrjedh nga vitet e kaluara. Shkalla tatimore per tatimin mbi fitimin per vitin ushtrimor eshte 10%.

"ROMANO-PORT" SHA DURRES

Shenime mbi Pasqyrat financiare

Per ushtirimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

k. Organizimi i Kontabilitetit

Departamenti i Finances perbehet nga nje ekonomist. Aktiviteti i shoqerise eshte i perqendruar ne Durres, ku shoqeria ka dhe zyrat administrative. Shoqeria ka organizuar dhe mban edhe kontabilitetin analitik ne funksion te nevojave te kontrollit dhe analizave te brendshme.

4. Likuiditete dhe Vlera te tjera Arke.

	2013	2012
Pershkrimi	ALL'000	ALL '000
Deposita ne banke e llogari te tjera	71	88
Vlera ne Arke	321	1,661
Totali	392	1,749

5. Llogari kerkesa te arketueshme

Shuma e pasqyruar meposhte perfaqeson kerkesat per arketim ndaj klienteve te shoqerise

	2013	2012
Pershkrimi	ALL'000	ALL '000
Kliente per fatuara te leshuara	36,118	42,054
Kliente per tu faturuar		0
Totali	36,118	42,054

Shoqeria ka mbajtur evidence analitike per çdo klient.

6. Llogari kerkesa te tjera te arketueshme

Nje analize e ketyre kerkesave jepet ne tabelen e meposhtme:

	2013	2012
Pershkrimi	ALL'000	ALL '000
Detyrime te tjera	3,860	2,882
TVSh e Zbritshme	0	8,986
Shpenzime te periudha te ardhshme	0	1,035
Totali	3,860	12,903

Shenimet shpjeguese jane pjese integrale e pasqyrave financiare

"ROMANO-PORT" SHA DURRES

Shenime mbi Pasqyrat financiare

Per ushtirimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

7. Inventari

Gjendja e inventarit perbehet nga materiale te para te paraqitura si me poshte:

Pershkrimi	2013	2012
	ALL'000	ALL '000
Lende te para	12,719	9,238
Totali	12,719	9,238

"ROMANO-PORT" SHA DURRES

Shenime mbi Pasqyrat financiare

Per ushtirimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

8. A.A.M.- Toka, Ndertesa, Makineri dhe Paisje, Aktive te tjera

Gjendja e aktive afatgjata materiale ne fund te vitit 2013 paraqitet ne menyre te permbledhur ne tabelen e meposhtme:

	Pershkrimi		Ndertesar	Makineri Pajisje	Automjetet	Te tjera	Ne proces	TOTAL
Bilanci i Celjes	01.01.2013	AQT Vlera Bruto	1,505,248,538	928,807,085	2,538,750	11,163,072	769,844,112	3,217,601,557
Bilanci i Celjes	01.01.2013	Amortiz Akumul	(210,848,513)	(215,506,503)	(1,538,214)	(4,828,494)		(432,721,724)
Bilanci i Celjes	01.01.2013	Provizione						
Bilanci i Celjes	01.01.2013	VLERA NETO	1,294,400,025	713,300,582	1,000,536	6,334,578	769,844,112	2,784,879,833
Hyrjet 2013		Vlera Bruto	71,462,994	12,580,937	207,216	3,440,415	209,609,426	297,300,988
Daljet 2013		Vlera Bruto						
Riklasifikim i Aktiveve								
Amortizimi i Vitit Ushtrimor			(66,118,665)	(53,903,483)	(100,052)	(1,409,299)		(121,531,499)
Provizionet								
Bilanci i Mbylljes	31.12.2013	AQT Vlera Bruto	1,576,711,532	941,388,022	2,745,966	14,603,487	979,453,538	3,514,902,545
Bilanci i Mbylljes	31.12.2013	Amortiz Akumul	(276,967,178)	(269,409,986)	(1,638,266)	(6,237,793)	0	(554,253,223)
Bilanci i Mbylljes	31.12.2013	Provizione						
Bilanci i Celjes	01.01.2014	VLERA NETO	1,299,744,354	671,978,036	1,107,700	8,365,694	979,453,538	2,960,649,322

Shenimet shpjeguese jane pjese integrale e pasqyrave financiare

"ROMANO-PORT" SHA DURRES

Shenime mbi Pasqyrat financiare

Per ushtirimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

Gjate vitit ushtrimor 2013 norma e amortizimit e perdoruara jane ato konform Ligjit per Te Ardhurat Tatimore. Makineri & Paisje jane ndare ne dy nengrupe. I pari ne makineri qe perdoren ne aktivitetin e portit dhe grupi i dyte jane ato pajisje qe i jane bashkangjitur portit dhe do te perdoren per shkarkimin e lendeve djegese. Llogarita e amortizimit esh te kryer bazuar ne rregullat fiskale per amortizimin e AAM-ve

9. Huate dhe obligacionet afatshkurtra

Shoqeria kete vit nuk ka marre hua ndaj bankave. E gjithë shuma perbehet nga detyrime per nje overdraft, shumat e llogaritura te interesave te akumuluar deri ne daten 31 Dhjetor 2013 si dhe shumat e principalit per kredite afatgjata qe do te paguhet gjate vitit 2014. Shumat detajohen si meposhte:

	2013	2012
Pershkrimi	ALL'000	ALL '000
Hua Afatshkurter (Overdraft)	25,806	40,819
Hua Afatshkurter (Interesa te Akumuluar)	9,663	16,666
Hua Afatshkurter (Principal per vitin 2013)	147,267	146,625
Totali	182,736	204,110

10. Te pagushme ndaj furnitoreve

Detyrimet e furnitoreve perben detyrimin qe kompania ka ndaj te treteve per blerje mallrash apo sherbime. Shoqeria ka mbajtur evidence analitike per çdo furnitor. Sipas tabelës së meposhtme per vitin 2013 ky detyrim paraqitet ne shumen **585,590 mije leke**.

	2013	2012
Pershkrimi	ALL'000	ALL '000
Furnitore per fatura te pranuar	585,036	446,830
Furnitore per faturuar te pa mberitura	554	510
Totali	585,590	447,340

"ROMANO-PORT" SHA DURRES

Shenime mbi Pasqyrat financiare

Per ushtirimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

11. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore per vitin 2013 paraqiten te detajuara si me poshte:

Pershkrimi	2013	2012
	ALL'000	ALL '000
Tatim Fitimi	5,907	15,014
TVSH e Zbritshme	833	0
Sigurimet Shoqerore	1,066	565
Tatim mbi te ardhurat personale	395	151
Detyrim tvsh ne dogane	0	3,622
Totali	8,201	19,352

12. Huate afatgjata

Shoqeria Romano-Port sha ka si detyrim ne kete ze nje kredi afatgjate marre nga tre banka per ndertimin e portit, qe si detyrim me date 31 Dhjetor 2013 paraqitet si me poshte:

Pershkrimi	2013	2012
	ALL'000	ALL '000
Hua, bono dhe detyrime nga qeraja financiare	590,308	792,613
Totali	590,308	792,613

Gjate ketij viti shoqeria nuk ka marre kredi te tjera afatgjate dhe ka vazhduar te shlyeje principalin qe i perket kredise syndicate. Pjese e ketyre kredive garantohen nga kolateralet e meposhtme:

- Hipoteke mbi stacionin e depozitimit te gazit nr pasurie 66/14 e cila ndodhet ne Porto Romano Durres perbere nga nje siperfaqe toke prej 27.683 m² dhe 5 depozita gazi ne pronesi te intergaz sha.
- Hipoteke mbi token me siperfaqe 48000 m² e ndodhur ne Porto Romano Durres ne zonen kadastrale nr.3184 me numra pronesie 64/109;64/106; 64/112; 64/22
- Hipoteke mbi pontilin e shkarkimit te naftes (ndertese me siperfaqe 634.74m²) me numer pasurie 96-ND
- Peng mbi 99.84% te aksioneve ne te cilat shprehet kapitali themeltar i shoqerise Romano Port sha
- Peng mbi gjendjen kreditore te tvsh dhe hipoteke (Grade e dyte) mbi pontilin e shkarkimit te naftes (ndertese me siperfaqe 634.74m²) me numer pasurie 96-ND.
- Peng mbi aksionet e shoqerise ne vleren 307,220,000 Leke.

"ROMANO-PORT" SHA DURRES

Shenime mbi Pasqyrat financiare
Per ushtirimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

13. Huamarje te tjera afatgjata

Edhe kete vit ka pasur hyrje dhe dalje te flukseve monetare si te ortakeve ashtu dhe kompanive si motra. Per keto hua nuk jane llogaritur apo paguar interesa. Shumat te detajuara i paraqesim ne tabelen e meposhteme:

Pershkrimi	2013	2012
	ALL'000	ALL '000
Huamarje te tjera (ortaket)	574,707	478,389
Huamarje te tjera (shoqerite motra)	70,220	77,496
Totali	644,927	555,885

14. Kapitali aksionar

Gjate vitit 2013 shoqeria nuk ka emetuar aksione te reja dhe mbetet ne shumen 597,686 mije leke.

15. Shitjet neto

Ky ze paraqitet ne vleren **417,609 mije leke** dhe jane te ardhura nga tarifat e shkarkimit per sherbimet e ofruara nga porti.

16. Te ardhura te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit

Ky ze paraqitet ne vleren 5,173 mije leke e detajuar ne tabelen e meposhtme:

Pershkrimi	2013	2012
	ALL'000	ALL '000
Nga shitja e materialeve/mallrave	3,455	1,134
Te tjera shitje e sherbime -qera	1,718	2,165
Te ardhura te tjera		157
Totali	5,173	3,456

Edhe kete vit shoqeria ka pasur te ardhura nga dhenia me qera e zyrove.

17. Puna e kryer nga njesia per qellime te veta

Ky ze gjate vitit ushtrimor te mbyllur me 31 Dhjetor 2013 paraqitet ne vleren 7,794 mije leke.

"ROMANO-PORT" SHA DURRES

Shenime mbi Pasqyrat financiare

Per ushtirimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

18. Mallra, lendet e para dhe sherbimet

Ky ze paraqitet si me poshte:

	2013	2012
Pershkrimi	ALL'000	ALL '000
Materiale te para	4,252	921
Totali	4,252	921

19. Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit

Ky ze paraqitet ne vleren 26,197 mije leke dhe paraqet shpenzimet e furniturave per vitin 2013. Tabela e me poshtme i jep me te detajuara:

	2013	2012
Pershkrimi	ALL'000	ALL '000
Shpenzime materiale	6,628	8,957
Blerje energji, avull, uje	3,123	2,935
Qira	2,400	0
Mirmbajtje dhe riparime	1,149	4,039
Prime sigurimi	679	921
Shpenzime te ndryshme	3,580	1,327
Shpenzime udhetime e dieta	227	0
Shpenz postare, telekom	909	760
Sherbime bankare	669	714
Te tjera tatime dhe taksa	494	142
Gjoba dhe demshperblime	6339	14,779
Totali	26,197	34,574

20. Shpenzimet e personelit

Ky ze paraqitet ne vleren 53,197 mije leke dhe paraqitet i detajuar si me poshte:

	2013	2012
Pershkrimi	ALL'000	ALL '000
Pagat	45,928	23,230
Sigurime Shoq&Shendetsore	7,269	3,877
Totali	53,197	27,107

Shenimet shpjeguese jane pjese integrale e pasqyrave financiare

"ROMANO-PORT" SHA DURRES

Shenime mbi Pasqyrat financiare
Per ushtirimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

21. Amortizimi dhe Zhvleresimet

Shuma e amortizimit te A.A.M. per vitin 2013 paraqitet ne vleren **121,531 mije leke**.

22. Te ardhura dhe shpenzime financiare

Vlerat ne kete ze jane paraqitur me vleren e tyre neto. Pra eshte bere diferenca midis te ardhurave dhe humbjeve respektive. Te detajuara i gjeni sipas tabelës:

Pershkrimi	2013 ALL'000	2012 ALL '000
Te Ardhura Financiare		
Interesa Positive	0	1
Diferenca pozitive kembimi	6,887	3,169
Shpenzime Financiare		
Interesa negative	(35,230)	(50,489)
Diferenca negative kembimit	(6,960)	(7,612)
Totali	(35,303)	(54,932)

23. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Ne percaktimin e rezultatit tatimor shoqeria ka marre ne konsiderate shpenzime e panjohura per efekte fiskale. Tabela e meposhtme e jep me qarte kete situatë:

Pershkrimi	2013 ALL'000	2012 ALL '000
Rezultati Kontabel	190,095	199,532
Gjoha e penalitete /demshperblime	6,339	14,778
Rezultati Tatimor	196,434	214,310
Humbje te mbartura	0	0
Fitimi tatimor	196,434	214,310
% e Tatim Fitimi	10%	10%
Tatimi mbi fitimin	19,643	21,431

Fitimi neto i shoqerise per vitin 2013 paraqitet ne shifrat **170,452 mije leke**

"ROMANO-PORT" SHA DURRES

Shenime mbi Pasqyrat financiare

Per ushtirimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

24. Transaksionet me palet e Lidhura

Pale te lidhura konsiderohen si te tilla ne rast se njera pale e kamundesine te kontrolloje palen tjetere ose te ushtroje nje influence te ndjeshme mbi kete pale, ne marrjen e vendimeve financiare dhe te shfrytezimit. Transaksionet me palet e lidhura te shoqerise detajohen si me poshte:

Pershkrimi	2013 ALL'000	2012 ALL'000
Totali I shitjeve me palet e lidhura	56,563	60,917
Totali i blerjeve me palet e lidhura	15,403	16,191

Gjendja ne 31.12.2013 me palet e lidhura detajohet si meposhte:

Pershkrimi	2013 ALL'000
Llogari te arketueshme me palet e lidhura	46
Llogari te pagueshme me palet e lidhura	6,281

Perfitimet e administratorit te shoqerise Z. Piro Bare gjate vitit 2013 paraqiten ne vleren 1,500 mije leke